Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Avdush Bajramaliu, *Ekspert shqyrtues i jashtëm*	*21.04.2022*	*30.04.2022*	**Nr. i lëndës:** **101/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.04.2022, Grupi i OE-ve: "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.-Ferizaj, kanë parashtruar ankesë me nr: **101/22**, kundër **Njoftimit mbi Vendimin e AK-së**, të **Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna Ferizaj** ,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Funksionalizimi i deponive te ngurta",** me nr. të prokurimit**: 656-22-1013-5-2-1,**nr.te brendshme: **656-22-22-521** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) **Komuna Ferizaj.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur** lloji i kontratës: **PUNË,** vlera e parashikuar e kontratës: **120 000,00 €**

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se ka pasur nje vendim

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE te OE.Ankues

Njoftimi për kontrate: 22.02.2022

Afati për dorëzimin e ofertës : 15.03.2022 ora 13:00

Njoftimi mbi Vendimin e AK-se 31.03.2022

Kërkesa për Rishqyrtim 04.04.2022

Vendimi per kerkesn per rishqyrtim 05.04.2022

Ankesa ne OSHP.14.04.2022

Pretendimet ankimore te personit fizik ,Ankues Grupi i .OE. "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.

1. **Neni 1 i LPP-**
2. **Neni 6 i LPP-se (Ekonomiciteti dhe efikasiteti)**
3. **Neni 7 i LPP-së (Barazia ne trajntim jo diskriminimi)**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga Grupi i .OE "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.-Ferizaj. lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Funksionalizimi i deponive te ngurta"**, me nr.të prokurimit**: 656-22-1013-5-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj**

4. **Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi,Vlersimi dhe Krahasimi)**
5. **Neni 69- Aftesit teknike dhe profesionale**
6. **Neni 39.8 i RRUOPP**
7. **Neni 72-Informata shtesë**
8. **Neni 108/A Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet e ankuesit

Autoriteti Kontraktues ne Aktivitetin e prokurimit **"Funksionaliz** i **deponive tengurta** ", me nr.prok. **656-22-1013-521**
GOE "NTP AR-SIMI; LUBOTENI-A SHPK; RICEA SHPK", me daten 04.04.2022, si

pale e pa kenaqur ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur kerkese per rishqyrtim per aktivitetin e prokurimit " **Funksionalizi mi i deponive te ngurta**" me nr. 656-22-1013-5-2-1 duke supozuar se eshte shkelur dispozita e Nenit 1, 6, 7 dhe 69te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues Komuna Ferizaj, nuk i **ka shqyrtuar pretendimet ankimore pasi qe ne vendimin e saj per refuzim nuk ka dhene ndonje sqarim detal lidhur me pretendimet tona ankimore por ka bere pergjigje duke pershkruar nenet e LPP-se bllanko dhe jo duke** i **shqyrtuar pretendimet tona ankimore.**

Lidhur me pretendimi ankimor per shkeljen e nenit 1,6 dhe 7 te LPP-se. AK ne kerkesen per rishqyrtim nuk ka shqyrtuar gje vetem se ka thene se : Neni 1, 6, 7 jane respektuar, porsi mendon AK se jane respektuar kur favorizimi i GOE se rekomanduar i cili i papergjegjshem eshte shperblyer me kontrate, duke mos respektuar LPP-ne dhe RrUOPP- ne, ka rekomanduar per kontrate nje GOE te papergjegjshem.

Respektimi i nenit 1, 6 dhe 7 te LPP_se, varet atehere kur respektohet dhe vleresohet pergjegjshmeria e Operatoreve Ekonomik qe i plotesojne kushtet sipas kritereve te kerkuara ne njoftim per kontrate dhe ne dosje te tenderit!

Pikrisht bazuar ne keto qe u than me lart ky OE eshte I papergjegjshem sipas nenit 59.4 te LPP-se sepse OE I rekomanduar per kontrate eshte I papergjegjshem ,andaj nese eshte I papergjegjshem sipas kritereve te kerkuara nuk mund te merren parasysh neni 1,neni 6 dhe neni 7 I LPP-së

Ju citojm se qfar thotë neni 1 dhe neni 6 I LPP-se

- **Paragrafi 1** i **Neni 1 -** Qellimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren me efikase , me

transparente dhe mete drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke percaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe dote ndiqen , te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te permbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndermarrjet , autoritetet kontraktuese, koncesioneret e puneve dhe organet publike qe zhvillojne, perfshihen , marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe perfshihen ose kane te bejne me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- **Paragrafi 1** i **nenit 6 -** Te gjitha autoritetet kontraktuese, jane te obliguara qe te sigurojne qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesishtduke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit.

Lidhur me arsyetimin e AK-se qe nuk ka shqyrtuar pretendimet tona ankimore, por ka dhene pergjigje jo siq duhet por bllanko, me kete ne si OE sqarojme se:

AK nuk e ka sqaruar se pse OE i rekomanduar eshte i papergjegjshem, pasi qe ne dosjen e OE-se se rekornanduar ky OE ka te prezantuar vetem nje Reference private dhe te padeshmuar per ekzekutim te punimeve, e qe sipas informatave qe kemi ky projekt ende eshte i paperfunduar, dhe si mundet qe nje OE te leshoj nje reference te padeshmuar per ekzekutim te puneve dhe te padeshmuar me transaksion bankar.

Kete shume mire e qarteson edhe Rregullat dhe Udhezuesi Operativ i Prokurimit Publikne faqe 65 te ketij Udhezuesi te ***Shenim per kerkesat e aftesise teknike dhelose profesionale (neni 69 i LPP-se):***

(ii)kur furnizimi është berë për një blerës privat, per deshmi te ketij livrimi sherben kopja e do dokumenti te nenshkruar nga bleresi dhe evidentimi i livrimit te tille;

Pra qfar eshte evidentimi i livrimit tjeter per verifikim permes transaksionit bankar,e qe AK nuk e ka respektuar kete per te verifikuar ,por e ka marr referenc si te pranuara e qe shihet se eshte referenc e dyshimt ,e qe me kete AK ka bere shkelje flagrante dhe jo qe duhet te eliminon kete GOE,por duhet te denoncon rastin qe te merren organet kompentente per verifikimin e references.

AK ka bere ka here shkeljen e nenit 7 te LPP-se, sepse e ka favorizuar nje OE tepapergjegjshem. Pra, me kete AK ka shkelur kete nen.

Paragrafi 1 dhe 2 i **Nenit** 7

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe dote veproje ne menyre transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do te ekzekutoje asnje aspekt te aktivitetit te prokurimit ne nje menyre qe redukton apo eliminon konkurrencen ne mes te operatoreve ekonomik ose qe diskriminon ne dem ose ne te mire te nje ose me shume operatoreve ekonomik.

Lidhur me shkeljen e nenit 7 te LPP-se nga Autoriteti Kontraktues, sqarojme se:

Nuk qendron arsyetimi i AK-se se jane vleresuar ofertat sipas kritereve dhe AK ne Vendimin e Kerkeses per Ri-shqyrtim thote se ne si AK kemi vepruar ne menyre transparente dhe kemi bere trajtim te barabarte te te gjitha ofertave.
Ju sqarojme se kjo nuk qendron ashtu siq pohon AK, sepse po te ishin vleresuar ofertat sipas Kritereve te kerkuara dhe duke u bazuar ne nenin 59.4 te LPP-se dhe Udhezuesit te Prokurimit Publik, ku ne kete udhezues ceket te Kriteri per Aftesite Teknike dhe Profesionale neni 69 te LPP-se, thote se per verifikimin e referencave private duhet te kerkohet verifikimi i tyre si ne piken (ii):
ii) kur furnizimi eshte here per nje bleres privat, per deshmi te ketij livrimi sherhen kopja e çdo dokumenti te nenshkruar nga hleresi dhe evidentimi i **livrimit te tille;**
Nuk po mund te kuptojme se çfare transparence ka pasur Autoriteti Kontraktues - Komuna Ferizaj, kur shkeljet flagrante duhet te ndiqen ne rruge te hetimeve vete nga ana e Autoritetit Kontraktues e jo te mbrohen dhe te favorizon kompanine e tille si ne rastin ne fjale ku Autoriteti e ka rekomanduar per kontrate kete grup te operatoreve ekonomik "Mirlind Abazi B.I. & MANI ESK SHPK .
Me kete AK ka qene dasht te eliminon kete GOE e jo te shperblej me kontrate.

Lidhur me pergjigjen e AK lidhur me nenin 69 te LPP-se, ne si OE sqarojme se:

Autoriteti Kontraktues - Komuna Ferizaj, ka dhene nje arsyetim ne Vendimin mbi Kerkesen per Rishqyrtim , ku ne kriteret e FDT-se dhe *NJK-se* ***Autoriteti Kontraktues ka kerkuar Reference te ngjashme,*** lidhur me natyren e puneve, kurse *OE i* ***rekomanduar ka reference per Rehabilitim te rrugeve,*** e qe aspak nuk ngjason me projektin **"Funksionalizimi** i **deponive te ngurta",** pra si mund te jete kjo reference e ngjashme menatyren e projektit dhe e pranuar nga ana e Autoriteti Kontraktues.

Ketu shihet qe AK po e favorizon GOE te rekomanduar per kontrate, sepse nuk i kaperfillur kriteret e vet kerkuara si ne FDT ashtu edhe ne NJK.

Poashtu AK-Komuna Ferizaj ne Pergjigjen e Kerkeses per rishqyrtim, qe kemi pranuar arsyetohet se OE kane te drejte ligjore te shfrytezojne pajisjet e nje OE tjeter, sie e thoteedhe paragrafi 6 te nenit 69 te LPP-se qe thote:

Nje operator ekonomik mund, kur eshte e pershtatshme dhe per nje kontrate te veqante. Te mbeshtetet ne kapacitetet e subjekteve te tjera. pa marre parasysh natyren ligjore te lidhjeve qe ajo ka me ta. Ai ne kete rast duhet te deshmoje per autoritetin kontraktues qe ajo do te kete ne dispozicion burimet e nevojshme per ekzekutimin e kontrates, per shembull. duke prodhuar nje ndermarrje nga ato entitete ne vend burimet e nevojshme ne dispozicion te operatorit ekonomik. Nen te njejtat kushte nje grup i operatoreve ekonomik mund te mbeshtetet ne aftesite e pjesemarresve ne grup ose ne subjekte te tjera.

Pra, me kete duke dashur AK qe te mbroj OE e rekomanduar nuk i ka shqyrtuar pretendimet tona ankimor, ashtu sic i kemi kerkuar ne kerkese per rishqyrtim, por eshte arsyetuar ne nenin 69.6 te LPP-se, sepse ne si OE nuk kemi thene se nuk ka te drejte te merr mjete ne shfrytezim, por ne kemi thene se si ka mundes i nje kompani nesa ka ekzekutuar nje kontrate me vlere **259,987.12 € dhe nuk ka asnje makineri te veten ne pronesi,** dhe **merr ne huazim makinerine (Kamion Kiper dhe eskavator) nga kompania LUNARI e cila eshte nje kompani nuk ekzekuton projekte te medhaja, ne mungese te makinerise qe ajo disponon..**

Lidhur me vendimin e AK-se te dates 31.03.2022, ku e ka rekomanduar per kontrate Grupine OE-ve: **Mirlind Abazi B.I; MANI ESK SHPK nga Ferizaj.**

Pra, sic e cekem edhe me larte se AK ka bere shkelje te vazhdueshme duke shkelur nenin 1,6,7 dhe 59 te LPP-se sepse duke na diskriminuar neve si OE i pergjegjshem me çmim me te lire, ka shperblyer me kontrate nje OE te papergjegjshem, sepse duke u bazuar ne qasjen e dokumenteve qe kemi pasur ne AK, shihet se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem.

Poashtu AK duke e shkelur nenin 69 te LPP-se (Aftesite teknike dhe profesionale), sepse ne Kriteret e kerkuara te FDT-se dhe Njoftimit per kontrate ka kerkuar kriterin:

Kerkesa: *Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka perfunduar me sukses kontrata te ngjashme, pune. ne 3 (tre) vitet e fundil (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit per kontrate), ne vlere minimale pre 120.000.00 €*

Deshmia: *Operatori Ekonomik duhet te ofroj listen e kontratave te nenshkruar dhe te vulosur ne origjinal. Ne liste duhet saktesuar titullin e kontrates. shumen e kontrates, daten e fillimit dhe daten e perfundimit dhe perfituesin. si dhe listës ti bashkengjiten referencat ose certifikatat per kryerje te puneve.*

- Te lista e projekteve dhe kriterit te kerkuar nga AK per Referenca te ngjashme, rezulton se referenca e bashkangjitur nuk eshte e ngjashme me referencen e kerkuar,per shembull:

***Autoriteti Kontraktues - Komuna Ferizaj per kete aktivitet te prokurimit ka kerkuar referenca te ngjashme te funksionalizimit te deponive te ngurta, ndersa OE ka ofruar referencen me titull: "Rehabilitimi** i **rruges Qamil Ilazi** & **Safi Bajra", pra shihet se nuk eshte referenca** e **ngjashme,** ashtu siç eshte kerkuar ne kriteret e FDT-se dhe Njoftimit per kontrate, por eshte nje reference per Rehabilitim te rrugeve. e cila nuk eshte specifike siç eshte kerkuar per kete aktivitet.*

Poashtu, vlen te ceket se ne dosjen** e **GOE te rekomanduar, konkretisht ne dosjen e liderit grupit MANI ESK shpk, eshte nje dokument "REFERENCE - CERTIFIKATE EPRANIMIT TEKNIK TE PUNEVE",** e **leshuar nga MANI ESK shpk per VIA SHPK me** date 18.01.2022, e nenshkruar dhe e vulosur nga VIA **SHPK** me emer te projektit"**Rehabilitimi i rruges Qamil Ilazi & Safi Bajra**" me vlere **259,937.12** € e perfunduar ne vitin 2021, pra kjo Reference eshte e dyshimt, per shkak se VIA shpk e ka leshuar - drejtuar **PER:** VIA **SHPK.

Edhe pse nuk eshte reference e natyres se njejte, kete Reference, Certifikate te kryerjes se punimeve duhet ta ben Komuna e Kaçanikut, sepse ata jane investitor te projektit e jo VIA SHPK.

Pra, kjo dyshohet ne falsifikim - mashtrim te AK-se nga OE VIA SHPK, dhe kjo ka qene dasht te verifikohet nga AK-Komuna Ferizaj , e qe ky Autoritet Kontraktues (Komuna Ferizaj) kete nuk e ka bere fare.

Pra, ketu shihet tendenca per te favorizuar nje OE dhe per te eliminuar shume OE te tjere. *Bazuar ne kriterin e kerkuar nga AK-ja, GRUP/ i OE-ve i larteshenuar nuk e plotesonkriterin e kerkuar sepse:*

- Grupi i OE-ve: "MIRLIND ABAZI B.1" & "MANI ES K" SHPK - eshte OE i rekomanduar per kontrate , ky Grup i OE-ve ka prezantuar listen e projekteve qe eshte prezantuar vetem nje projekt i cili eshte ekzekutuar ne Komunen e Kaçanikut

Pra, projekti i ekzekutuar ne kete komune , eshte me titull: "**Rehabilitimi** i **rruges Qamil llazi** & **Sali Bajra",** i cili **projekt eshte** i **nenshkruar me date 06.07.2021** ne mes te **Komunes se Kaçanikut dhe Grupit te OE-ve: VIA SHPK; EUROKOS HOLDING SHPK; Terziu Group SHPK; NORTINI SHPK nga Lipjani, me vlere te kontrates: 259,987.12** €.

Sipas kontrates, rezulton se projekti ne fjale eshte ekzekutuar nga VlA SHPK si lider i Grupit se bashku me anetaret e tjere te konzorciumit, ku ne kontraten e nenshkruar ne mes te Komunes dhe

Grupit te OE-ve te siperthekesuar *nuk ceket askund se eshte nenkontraktuar MANI ESK* ***SHPK*** per te ekzekutuar kete projekt, por mendojme se ketu ka nje lajthitje nga **VIA SHPK,** sepse sipas References se Ieshuar *nga vet* ***VIA SHPK*** *PER: VIA SHPK, ku ketu nenkuptojme se VIA SHPK i ka leshuar reference vetvetes ,* e ne *brendi te references se leshuar nga* ***VIA SHPK*** *me date 18.01.2022 ceket se nenkontraktor I00% per ekzekutimin e projektit ka qene :* ***MANI ESK SHPK*** *me vlere te projektit* ***259,987.12 €****, vlere kjo e nenshkruar ne mes te* ***Komunes se Kaçanikut dhe Grupit te OE-ve: VIA SHPK; EUROKOS HOLDING SHPK; Terziu Group SHPK; NORTINI*** *SHPK nga Lipjani*

Pra , shihet shume qarte se askund ne kontrate, nuk permendet MANI ESK SHPK si nenkontraktor i projektit. Poashtu nese eshte e vertete kjo duhet te ceket ne kontrate dhe permes kontrates te ekzekutohet pagesa direkt te OE i nenkontraktuar si ne rastin konkret MANI ESK SHPK.

Kjo duhet te deshmohet me qarkullim bankar se e ka ekzekutuar punen 100% ashtu edhe sic ceket ne referencen e leshuar nga VIA SHPK, per VIA SHPK, me vlere 259,987.12€.

Pra, sipas Ligjit te Prokurimit Publik dhe RrUOPP-se, marreveshja per nenkontraktimin e puneve eshte maksimum 40% e puneve te vleres se projektit mund te nenkontraktohet, kurse ne rastin konkret sic ka prezantuar ne reference, se VIA SHPK ia ka nenkontraktuar 100% te punimeve, nje OE qe ska qene pjese e konzorciumit, por ka gene krejtesisht i jashtem, per kete marreveshje qofte reale apo edhe fiktive ky OE duhet te mbaj pergjegjesi sepse vet OE VIA SHPK bie ndesh me Dispozitat e LPP-se dhe RrUOPP-se, sepse nuk mundet asnje Autoritet Kontraktues, nuk e lejon nenkontraktimin 100% te vleres se kontrates, si ne rastin konkret

Gjithashtu vlen te ceket se si ka mundesi qe ***MANI ESK SHPK te ekzekuton nje kontrate 100%*** *te projektit, ku sipas listes se prezantuar te pajiseve shihet se ka nje marreveshje shfiytezimi me LUNARI SHPK - Ferizaj, gjegjesisht per shfiytezimin e pajisjeve te kerkuara ne dosjen e tenderit dhe ne Njoftim per kontrate (citim i kriterit): sine piken III.2.4 te Njoftimit per kontrate:*

Kerkesa: Lista e mjeteve te punes dhe ate se paku - 3 eskavator , - 2 kamion kiper ***Deshmia:*** Lista e mjeteve te punes (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Deklaratat unike doganore ose kontrata te blerjeve ose fatura e blerjes per automjetet qe NUK regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit per automjetet qe regjistrohen.Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronesine duhet te ofroj marreveshjen per marrjenme qira te pajisjeve . **Marreveshja duhet te jete ne emer te ketij projekti me validitet te kohezgjatjes te kesaj kontrate e nenshkruar dhe vulosur nga te dyja palet dhe e**

noterizuar.

Pra, kriteri i kerkuar i FDT dhe NJK eshte se **marreveshja e nenshkruar ne mes te paleve duhet te jete e noterizuar.** e qe ne rastin ne fjale nuk eshte e noterizuar marreveshja , dhe me kete AK ka bere shkeljen flagrante te nenit 69 te LPP-se , sepse nuk i ka respektuar kriteret e kerkuara nga vet AK, por ka favorizuar nje OE duke i diskriminuar te gjithe OE e tjere.

Me kete ky OE duhet te eliminohet e jo te shperblehet me kontrate, sepse nuk i ploteson kriteret e kerkuara te FDT-se dhe Njoftimit per kontrate!

Me kete kerkojme nga OSHP, qe ti shqyrton pretendimet tona ankimore, dhe konform pretendimeve te verifikohen referencat dhe pajisjet e bashkangjitura si ne dosje, e qe per te cilat mendojm se jane referenca fiktive dhe qe kjo duhet te penalizohet sipas LPP-se OE i rekomanduar sipas nennit 99.2 dhe jo te shperblehet me kontrat nje Operator i tillë.

Kerkojme nga OSHP-ja, por edhe ne organet kompetente per verifikimin e References dhe marreveshjes se noterizuar e qe OE i rekomanduar nuke ka marreveshjen e noterizuar per shfrytezim te mjeteve-makinerise dhe me kete ky GOE duhet te eliminohet e jo te shperblehet me kontrate.

Ne kete rast Autoriteti Kontraktues nuk e ka verifikuar origjinalitetin e references, por AK e ka arsyetuar se referenca eshte pune e ngjashme , duke mos e sqaruar fare pretendimin tone ankimor qe e kemi te bazuar.

Pra, te gjitha faktet e paraqitura ne kete ankese jane te qendrueshme dhe kerkojme nga OSHP duhet ti merr parasysh, dhe te kthej lenden ne rivleresim , sepse shihet haptaz diskriminimin qe e ka bere AK ndaj neve si OE ofertues dhe duke e favorizuar OE e rekomanduar duke mos i respektuar dispozitat ligjore, konkretisht duke mos respektuar RrUOPP-ne qe per referencat private e thote shume qarte se duhet te verifikohet qarkullimi apo livrimi i tyre (citim): **(ii)kur furnizimi** eshte here per nje bleres privat, per deshmi te ketij livrimi sherben kopja e do dokumenti te nenshkruar nga bleresi dhe evidentimi i livrimit te tille;

Permes kesaj ANKESE, kerkojme nga OSHP *që të merr:*

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **GOE N.T.P."AR-SIMI; LUBOTENI-A SHPK;**

RICEA SHPK- Ferizaj

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se,

OBLIGOHET autoriteti kontraktues qe te beje rivleresimin e ofertave per arsye se NE si OE e kemi oferten e pergjegjshme me cmim mete lire dhe se ne duhet te shperblehemi me kontrate.

1. Demet materiale

Demet materiale te shkaktuara o·er me tani kap in shumen afer 2000 euro.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesa:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, pune, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 120,000.00 €	**Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur ne origjinal . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te puneve.**
Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 3 eskavator, - 2 kamion kiper	**Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Deklaratat unike doganore ose kontrata te blerjeve ose fatura e blerjes për automjetet qe NUK regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar**

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ne rasportin e vlersimit dhe ne letren standarde qe i ka perciell OE,ankuese AK- OE ankuese e ka theksuar se ky OE,eshte i pasukesesshme qe dmth.OE i kompletuar po me çmim jo me te lire se OE i Rekomanduar per kontratë.

(Të përshkruhet vetëm vlërësimi i ofertësë OE ankues /ofertave, por të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga Grupi i .OE "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.-Ferizaj. lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Funksionalizimi i deponive te ngurta"**, me nr.të prokurimit**: 656-22-1013-5-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj**

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet njëvlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:

GOE.Ar-simi; Luboteni-A; Ricea-Ferizaj

Sqarimi i lëndës nga eksperti

Lidhur me pretendimet ankimore te Grupit të OE-ve ankues, sipas pretendimeve ankimore të tyre, si ekspert shqyrtues i lendes jap kete sqarim:

1. Pretendimet ankimore te OE-se ankuese theksojm se OE-ne këto pretendimi ka theksuar se AK- ne ka shkelur ligjin konkretisht nenin 1 te LPP-së qe ben fjale per at qe citim ”**Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla**”, ***ku mendoj se ky pretendim ankimor eshte pjesërisht i bazuar sepse AK ne rastin konkret nuk e ka respektuar kete parim te nenit I te LPP-së.***

2. Sa i perket pikes se dytë ankimore per shkelje te nenit 6 te LPP-së (ekonomiciteti dhe efikasiteti) ne kete rast AK- mendoj se nuk e ka respektuar kete nen sepse sipas LPP-se dihet se oferta me e lire merret parasysh atehere kur se pari duhet te plotesohen kriteret e kerkuara te perzgjedhjes si ne FDT dhe Njoftim per kontrate dhe me pastaj do te meret parasysh çmimi i OE pjesemarres, sepse po te mos i plotesojne kriteret OE ofertues atehere ofertat e tyre jane te papergjegjshme, si ne rastin konkret OE i rekomanduar per kontrate, nuk i ka plotesuar kriteret e kerkuara te FDT-se dhe Njoftimit per kontrate dhe eshte rekomanduar per kontrate!.

3. Tek pretendimi tretë ankimor per shkelje te nenit 7 te LPP-së (Barazia ne trajtim) edhe kjo pike e ankeses eshte pjeserisht e bazuar sepse AK gjate udheheqjes se ketij aktiviteti te prokurimit nuk e ka trajtuar ne menyre te

barabarte OE- ankuese sidomos gjate procesit te versimit te tenderit dhe dhenie se kontrates,AK-nuk i ka respektuar te gjitha kriteret qe i ka percaktuar vete ne NJK dhe ne Dosje te tenderit sidomos tek kriteret e aftesive teknike dhe profesionale.

4. Pretendimi ankimor per shkeljet e nenin 69 i LPP-së (Aftesit teknike dhe profesionale) janë të bazuara sepse AK gjate udheheqejes e ketij aktiviteti nuk i ka respektura kriteret e kerkuer ne NJK,konkretisht tek kriteri si me poshtë :

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, pune, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 120,000.00 €	**Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave te nënshkruar dhe te vulosur ne origjinal . Ne listë duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te puneve.**

OE. i rekomanduar ne kete rast nuk ka sjell deshmi konkrete se ka perfunduar me sukese kontrata te natyres se ngjashme per tre (3) vitet e fundit, po ashtu OE.i rekomanduar per kontratë nuk ka sjell listen e kontratave ashtu siq eshte kerkuar te NJK,,por ka sjell nje listë pa saktesuar se kur ka perfunduar ky projekt ,po ashtu nuk i ka te bashkangjitur as reference kesaj liste po figuron nje referencë private nga (VIA SHPK) , nga OE qe ka ekzekutuar kete projekt per AK-Komuna e Kaçanikut.

Referencën duhet ta leshon AK-Komuna Kaçanik si invesitor i projektit per OE qe e ka ekzekutuar projektin, dhe ne rast se eshte nenkontraktor ofertuesi (MANI ESK) ateherë sipas kushteve te kontrates, kontraktuesi duhet ti leshon reference nenkontraktuesit me vleren e perfunduar nga nenkontraktuesi si deshmi se kontrata ka perfunduar dhe eshte realizuar, kurse ne kete rast eshte nje referenc private pa deshmi konkrete (pa transaksione bankare per realizim te kesaj kontrate), e aq me keqe pa te dhena te nevojshem duke e ditur se OE i Rekomanduar nga AK-Komuna Ferizaj, ne kete rast AK nuk i ka kerkuar deshmi shtese per livrimin apo qarkullimin e mjeteve se ato mjete a i kane kaluar ne llogari OE MANI ESK SHPK.

Poashtu as ne kontraten e nenshkruar nuk ceket se si nenkontraktor eshte OE i REKOMANDUAR nga AK-Ferizaj ”**Mirlind Abazi” B.I.& “MANI ESK” SHPK**.

Pretendimi ankimor i GOE eshte i bazuar

Po ashtu si mangesi tek Aftesit teknike dhe profesionale shihet se AK-nuk i ka respektuar kriteret e saj si me posht :

Kapaciteti teknik dhe professional: **Lista e mjeteve te punës dhe ate se paku - 3 eskavator, - 2 kamion kiper**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Lista e mjeteve të punës (e nenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per keto automjete duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Deklaratat unike doganore ose kontrata te blerjeve ose fatura e blerjes për automjetet qe NUK regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e noterizuar**

OE. i rekomanduar ka sjell deshmi listen e paisjeve me OE,"Lunari Company" SHPK,duke i bashkangjitur listen e makinerisë me librezat dhe faturat e blerjes, por OE, i Rekomanduar (OE,"Mirlind Abazi B.I.& MANI ESK SHPK."), ka sjell si deshmi edhe marrveshjen per shfrytezimin e makinerise por te PANOTERIZUAR, pra jo ashtu siq ka kerkuar AK-ja ne kriteret e saj.(**Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët dhe e NOTERIZUAR)"**

Pretendimi ankimor i GOE eshte i bazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues te OSHP-së qe pretendimet ankimore siq i theksuam me lartë jane te bazuara dhe Autoriteti Kontraktues lënden ta kthen ne RI-VLERËSIM dhe gjate RIVLERËISMIT ti respektoj kriteret qe i ka percaktuar ne NJK dhe Dosje te tenderit.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues: **AK - Komuna e Ferizajit**
- Panelit Shqyrtues: **OSHP-së**
- OE ankues: **Grupi i .OE "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.-Ferizaj**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga Grupi i .OE "Ar-simi", "Luboteni-A"SHPK. dhe "Ricea"SHPK.-Ferizaj. lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Funksionalizimi i deponive te ngurta"**, me nr.të prokurimit**: 656-22-1013-5-2-1**, iniciuar nga **Autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj**